



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 1821/12 prot.

Tiranë, më 26.02.2019

VENDIM

Nr. 16, datë 26.02.2019

PËR

NGRITJEN E TRUPIT GJYKUES QË DO TË VENDOSË PËR DORËHEQJET E
SUBJEKTEVE TË RIVLERËSIMIT

Në mbështetje të nenit "G" të Aneksit të Kushtetutës, të nenit 56, të ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", si dhe vendimit nr. 16, datë 7.3.2018, të Komisionit, në mbledhjen e datës 26.02.2019, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit,

V E N D O S I:

1. Ngritjen e një trupi gjykues që do të vendosë për dorëheqjet e subjekteve të rivlerësimit.
2. Përbërja e trupit gjykues, zgjedhur me short, është:
-Komisioneri **Pamela Qirko**;
-Komisioneri **Lulzim Hamitaj**;
-Komisioneri **Etleda Çiftja**.
Anëtar zëvendësues është komisioneri **Brunilda Bekteshi**.
3. Trupi gjykues do të ushtrojë këtë detyrë për periudhë njëvjeçare (8 mars 2019 - 8 mars 2020).
4. Trupi gjykues i radhës do të zgjidhet pesëmbëdhjetë ditë para mbarimit të detyrës së trupit gjykues aktual.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Genta Tafa (Bungo)

